



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3515/3 Prot.

Tiranë, më 19.12 2023

VENDIM
Nr. 137 datë 19.12 2023

PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES PËR PJESËMARRJEN E UNIVERSITETIT
TË SPORTEVE TË TIRANËS SI PARTNER NË PROJEKTIN "EQUAL"
TË ALEANCËS EVROPIANE UNIVERSITARE

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma "c" dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në nenin 20, pika "s" të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 122 datë 12/12/2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19/12/2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në projektin "EQUAL: Enhancing Quality of Life – European University (Body – Mind – Society)" të Aleancës Evropiane Universitare (European Universities Alliances).
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT
Prof.Dr. AGRON KASA

